



Breaking News:

Kurbin/Ndërhyrja e menjëhershme e Policisë parandalon një ngjarje të mundshme kriminale



27/04/2023

Kurbin/Ndërhyrja E Menjëhershme E Policisë Parandalon Nje Ngjarje Të Mundshme Kriminale

Kurbin/Ndërhyrja e menjëhershme e Policisë parandalon një ngjarje të mundshme kriminale.

Kërcënoi me armë gjahu, punonjësit e një firme private, të cilët po merreshin me shtrimin e një rruge, pasi pretendonte se ky territor ishte pronë e tij, kapet në flagrancë 48-vjeçari.

Sekuestrohet arma e gjahut “Shotgun” dhe municion luftarak.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kurbin, pas marrjes së njoftimit, rreth orës 12:00, se në fshatin Shpërdhet, një shtetas po kanoste me armë gjahu, disa punonjës të një firme private, të cilët po merreshin me shtrimin e rrugës së gurorëve në këtë fshat, menjëherë kanë organizuar punën dhe kanë mbërritur në vendngjarje, me qëllim parandalimin e një ngjarjeje të mundshme kriminale.

Si rezultat i ndërhyrjes së menjëhershme dhe i veprimeve të shpejta operationale, është kapur në flagrancë dhe është shoqëruar në Komisariat, për kryerjen e veprimeve të mëtejshme procedurale, shtetasi A. D., 48 vjeç, banues në Mamurras.

Në momentin e ndërhyrjes, Policia i ka sekuestruar 48-vjeçarit, armën e gjahut “Shotgun” dhe municion luftarak.

Nga hetimet paraprake, dyshohet se 48-vjeçari, për shkak se pretendon pronësinë mbi këtë territor, ka kërcënuar me armë gjahu, punonjësit e një firme private, të cilët në kuadër të një projekti të miratuar nga bashkia e Kurbin, po merreshin me shtrimin e rrugës së guroreve.

Shërbimet e Komisarariatit të Policisë Kurbin, në drejtimin e Prokurorisë, vijojnë veprimet hetimore për dokumentimin e plotë ligjor të këtij rasti.

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Kurbin, për veprime të mëtejshme.



Kërko

Enter a word for search



Komisariati Dixhital

GET IT ON
Google Play



Download on the
App Store

Arkiva

Select Month

Linqe

- > [Arkiva](#)
- > [Akademia e Sigurisë](#)
- > [Ministria e Brendshme](#)
- > [Agjencia e Mbikëqyrjes Policore](#)
- > [Interpol](#)
- > [Europol](#)
- > [Misioni PAMECA V](#)
- > [SCPA](#)
- > [Projekti Trivalent](#)

◀ DVP Korçë/Procedohet në gjendje të lirë 1 shtetas, shpallet në kërkim 1 tjetër

Lezhë – Gjendet dhe sekuestrohet motomjeti i përdorur nga ekzekutori, për vrasjen e shtetasit Ardian Nikulaj ▶